



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

Universiteti i Shkodrës "Luigj Gurakuqi"

Nr. 3074 Prot

Shkodër, më 04.10.2017

U D H E Z I M

Nr. 288 datë 04.10 2017

Për procedurat e pranimit në programet e ciklit të dytë për vitin akademik 2017-2018

Në mbështetje të ligjit nr. 80, datë 22. 07. 2015''Për arsimin e lartë dhe kërkimit shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë'', neni 25, udhëzimit të MAS nr.15, datë 19.05.2017 "Për procedurat e aplikimit dhe të regjistrimit në vitin akademik 2017-2018" dhe Udhëzimit nr.18 datë 16.08.2017, Statutit të U.SH-së dhe Rregullores së studimeve të U.SH-së:

udhëzoj:

Procedurat e pranimit në programet e ciklit të dytë "Master profesional" dhe "Master i shkencave" për vitin akademik 2017-2018 do jenë si më poshtë:

A.Procedurat e aplikimit

1. Aplikimi në programet e studimit të ciklit të dytë me kohë të plotë të kandidatëve do të bëhet pranë sekretarive mësimore të fakulteteve përkatëse **nga data 06 tetor deri me datën 20 tetor 2017 nga ora 8:00 deri 16:00.**
2. Kanë të drejtë të aplikojnë për programet e ciklit të dytë kandidatët që:
 - a- kanë përfunduar me sukses studimet dhe janë paisur me diplomën përkatëse të vlefshme në Republikën e Shqipërisë në një program të ciklit të parë i cili rezulton i licensuar dhe i akredituar në momentin e diplomimit të studentit.
 - b- janë diplomuar jashtë vendit në një program studimi të ciklit të parë të akredituar. Në rast pranimi kandidati është i detyruar të kryejë njësimin e diplomës pranë MAS brenda muajit dhjetor 2017.
3. Brenda datës **24 tetor** fakultetet shpallin listat e fituesve në mjediset e tyre dhe në faqen ëeb të USH, të renditur sipas rendit zbritës të pikëve të grumbulluara, bazuar në kuotat e miratuara për çdo program studimi.
4. Kandidatët kanë **të drejtën e ankimit** brenda **tre ditëve** kalendarike nga dita e shpalljes së rezultateve. Dekani i fakultetit shprehet me **vendim** brenda **dy ditëve** punë nga data e paraqitjes së ankimit.



5. Aplikantët duhet të paraqesin për aplikim dokumentacionin e përcaktuar në Udhëzimin nr.18 datë 16.08.2017 kreu VI/4 pika 9,a,b,c,d,e.

a- për kandidatët që aplikojnë për "Master i shkencave" duhet të kenë të mbrojtur gjuhën e huaj sipas Udhëzimit nr. 52 datë 03.12.2015.

B. Regjistrimi i fituesve

1. Regjistrimi i kandidatëve në programet e studimit ku janë shpallur fitues zhvillohet pranë sekretarive mësimore përkatëse nga data **26 tetor 2017** deri me datën **30 tetor 2017**.

2. Pranimi dhe regjistrimi i kandidatëve në programet e ciklit të dytë të studimeve me kohë të plotë në vitin akademik 2017-2018 bëhet në bazë të kuotave respektive të deklaruara nga USH, sipas kriterëve të miratuara në dhe përzgjedhjes së bërë nga fakultetet konform akteve ligjore e nënligjore në fuqi.

3. Fakultetet shpallin në mjediset e tyre dhe në faqen eeb të USH listat e kandidatëve që janë regjistruar brenda datës **1 nëntor 2017**.

Ky udhëzim hyn në fuqi menjëherë.

Rektori



Prof. dr. Adem BEKTESHI